

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vjeshtën e vitit 2017 ne, si maxhorancë qeverisëse, nuk mbetëm vetëm në kuadrin e premtimeve të dhëna dhe diskutimeve për një qeverisje së bashku me bashkëqytetarët. Nuk bëhej fjalë për fushatë elektorale apo për një përpjekje të pastrukturuar, por bëhej fjalë për diçka të premtuar që do të sillte risi në mënyrën e qeverisjes, duke e konsoliduar këtë angazhim në dy pjesë: Së pari, në ngritjen dhe funksionimin e Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Së dyti, pajisjen e kësaj agjencie me platformën online “Shqipëria që duam”. Për të treguar se një qeverisje e mirë mbetet e tillë nëse ajo dëgjon në mënyrë të drejtë dhe transparente qytetarët dhe përmirëson marrëdhëniet mes zyrtarëve publikë, ne vendosëm që këtë eksperiencë të re të bashkëqeverisjes ta bënim në një moment kur e gjithë teknologjia e administratës publike po avanconte. Bëhet fjalë sot për individë nga vende të tjera të botës që kërkojnë të shkojnë në turizëm hapësinor. E kuptoni se sa shumë e rëndësishme është dhe për Shqipërinë që, në vend të dosjeve, të cilat mbeten nëpër korridoret e ministrive, në vend të shkresave që nuk merrnin përgjigje, sidomos për qytetarët dhe për bizneset, të gjenim një formë të re dhe të vendosim një institucion përgjegjës për t’u dhënë atyre përgjigje. Përdorëm mekanizmat që ofronte inovacioni i kohës.

Krijua një agjenci që mori këtë përgjegjshmëri dhe dhamë ndihmë te platforma online “Shqipëria që duam”, ndërkohë që punonim për digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve publike. Sot që flasim, kemi 1209 shërbime publike, asistojmë më shumë se 2 milionë individë që kanë nevojë për këto shërbime. Ndërkohë që qytetarët marrin përgjigje për hallet, ankesat, sugjerimet që kanë, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje vazhdon punën e saj duke trajtuar letrat, ankesa, të cilat sot vijnë në një formë digjitale, vijnë vetëm me një klik pranë agjencisë. Në fakt, nëse do ta shikojmë me kujdes aktivitetin që ka bërë agjencia në këtë periudhë, vihet re që më shumë se 25 mijë individë, të cilët kanë aplikuar te platforma “Shqipëria që duam”, janë bërë përdorues të rregullt të platformës eAlbania. Nga ana tjetër, platforma nuk mbeti vetëm në marrjen e ankesave nga qytetarët, bizneset apo subjektet e së drejtës, por krijoi një model të ri që ishte modeli i interpelancës. Janë organizuar 42 interpelanca, sepse ne të gjithë këtu punojmë për të bërë paketa të reja ligjore, për të përafuar një legjislacion të caktuar me atë të BE-së, nxjerrim rregulla, urdhëresa, vendime të Këshillit të Ministrave që janë proces i punës sonë. Qytetarët e Republikës së Shqipërisë kanë nevojë t’i dëgjojnë, t’i kuptojnë të gjitha këto angazhime që marrim ne si politikëbërës në jetën e tyre të përditshme. Natyrisht që duhet një interlokutor, deri më parë ka qenë letra, sot është kjo platformë dhe mënyra e organizimit të kësaj platforme e ndihmon qytetarin. Nga ana tjetër, të mos harrojmë që këto letra, ankesa ose sugjerime nuk janë pjesë vetëm e jetës politike dhe e marrëdhënies që krijon qeveria me qytetarin, por në të gjithë botën shikojmë praktika të tilla. Në senatin amerikan shkojnë e vijnë pa fund letra nga komunitetet, nga individët dhe senati amerikan përgjigjet. Pak kohë më parë Presidenti i Francës kishte një uebsajt dedikuar qytetarëve francezë. Prandaj, Shqipëria nuk po bën ndonjë gjë që nuk ndodh në botën Perëndimore, po forcon më tej të gjithë inovacionin, për të cilin ajo ka marrë

lavdërimi dhe është njohur nga OECD-ja, nga ReSPA për digjitalizimin e vazhdueshëm që po u bën shërbimeve publike. Kur ne kaluam disa periudha të vështira, platforma e bashkëqeverisjes u dha përgjigje ngjarjeve të vështira që kaloi vendi (të mos harrojmë tërmetin); ka akomoduar dhe u ka dhënë përgjigje 2 775 ankesave, kërkesave, nevojave për lëvizje në territor të individëve në zonat e prekura nga tërmeti; u ka dhënë mundësi të komunikojnë dhe të zgjidhin problemin që kanë gjatë kohës së pandemisë 32 313 individëve nëpërmjet një sistemi pop up-i që ka platforma. Të mos harrojmë që po kjo platformë u përdor edhe në “Paktin për universitetin”. Platforma kishte pjesën “Jam student, pyetja ime...” dhe kishte një pop up në platformë, pra shumë studentë e pedagogë reagues aty së bashku për të bashkëpunuar për “Paktin për universitetin”. Nuk ishin pak ata që morën shërbime në raste të tilla. Ishin rreth 2 mijë studentë që kontribuuan në platformë. Platforma, nga njëra anë, grumbullon informacionet, shikon nevojën, zgjidh rastet; dhe rastet e suksesit kanë qenë më shumë se 75% nga 140 mijë ankesa të vendosura në platformë, por vë përpara edhe atë zyrtarë e vogël, i cili nuk e vë në vesh kërkesën dhe kushtin që ka Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që një nëpunës civil është aty shërbëtor i qytetarëve të këtij vendi, i qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi. Duke u nisur nga këto kushte, kemi nevojë të çojmë përpara digjitalizimin, kemi nevojë kur duam t’u japim qytetarit dhe biznesit një përgjigje të shpejtë.

Ne duam të bëjmë modele të mira të njohura në të gjithë botën, ku bashkëpunimi midis qeverisë dhe qytetarëve është i plotë. Nuk mjaftonte vetëm vendimi i Këshillit të Ministrave që kishim për funksionimin e kësaj agjencie, por ka nevojë t’i shtojmë një hallkë të re kornizës ligjore që ka agjencia. Prandaj propozojmë këtë projektakt për t’i dhënë fuqi çdo qytetari, pavarësisht se ku ndodhet, në zonë rurale apo në zonë urbane, është i majtë apo i djathtë, është në punë apo i papunë, ai ka gjithmonë nevojë për shërbimet e shtetit. Kjo platformë e mundëson këtë gjë, jo vetëm për qytetarin, duke i dhënë atij një rol më të fuqishëm, por vë përpara përgjegjësisë edhe të gjithë administratën publike, e cila duhet t’i ndjekë me përpikëri të gjitha standardet e shërbimeve dhe afatin me të cilin jepen shërbimet. Për më tepër që nëpërmjet kësaj platforme do të bëhen dhe ato që quhen riinxhinierime të procesit të shërbimeve. Platforma do të ketë një rol ndërmjetës, konsultativ, i cili nuk do t’i zëvendësojë të gjitha kërkesat që vijnë qoftë nga Kodi i Procedurave Administrative, por nuk do të zëvendësojë as organet e llogaridhënies. Platforma do të jetë atje për t’u shërbyer individëve dhe për të vënë përpara përgjegjësisë ata që nuk kuptojnë se roli i shërbyesit është roli më i rëndësishëm që na japin zgjedhësit në një moment si ky. Unë dua të falënderoj Agjencinë për Dialog për punën e madhe që ka bërë dhe për të gjitha rastet që ajo ka përcjellë me sukses! Të mos harrojmë se rastet e përcjella me sukses kanë sjellë që vitin 2019 të kishte edhe një shërbim të ri: koordinatori i biznesit. Të mos harrojmë për asnjë çast se kjo punë nuk do të bëhej nëse individët në të gjithë Republikën e Shqipërisë nuk do të jepnin opinionin e tyre.

Dua të falënderoj edhe Komisionin e Ligeve për shtjellimin që i kanë bërë çështjes, si dhe koleget Spiropali, Eridana Çano që kanë punuar shumë mirë për të sjellë përpara nesh në mënyrë shteruese të gjithë nevojën që kemi për këtë projektakt të ri! Ju ftoj ta votojmë atë. Faleminderit!